



Datë: 20.06.2025
Numër Protokolli: 992/2025

A.nr.1790/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1790/2024 të datës 29.11.2024 të parashtruar nga ankuesi B.J, kundër Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë-Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1790/2024 e datës 29.11.2024, e parashtruar nga ankuesi B.J, **ndërsa mbeten në fuqi** Njoftimet e datës 30.10.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, lidhur me përfundimin e procedurës së pranimit më numër të referencës RN00014898, për pozitën *Drejtor i Departamentit për Hulumtime* si dhe përfundimin e procedurës së pranimit me numër të referencës RN00014899, për pozitën *Drejtor i Departamentit të Dokumentimit*.

II. Shfuqizohet Vendimi A.nr.1790/2024 i datës 05.02.2025 dhe numër protokolli: 992/2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

A r s y e t i m

Ankuesi B.J, (në *tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 29.11.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimeve të datës 30.10.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, sipas të cilave njoftimeve rezultoi se procedura e rekrutimit për pozitën *Drejtori i Departamentit të Dokumentimit* si dhe procedura e rekrutimit për pozitën *Drejtor i Departamentit për Hulumtime*, në kuadër të Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (në *tekstin e mëtejme referuar: IKKL*), kanë përfunduar pa fitues sepse asnjë nga kandidatët nuk ka kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të vlerësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, ndërsa, ky i fundit, më datë 30.12.2024, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 100/2025 të datës 10.01.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6592/2024, të parashtruar nga ankuesi më datë 29.11.2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Njoftimin e datës 30.10.2024; Renditjen përfundimtare; Ftesën për intervistë, të datës 21.10.2024; Njoftimin e datës 21.10.2024; Njoftimin e datës 02.10.2024; Ftesën për testin me shkrim, të datës 10.10.2024; Ftesën për testin me shkrim të datës 14.10.2024; Njoftimin e datës 02.10.2024; Konkursin me numër reference RN00014899; Konkursin me numër reference RN00014898; Njoftimin e datës 30.10.2024; Renditjen përfundimtare; Njoftimin e datës 21.10.2024; Njoftimin e datës 02.10.2024; Përgjigjen në ankesë të datës 30.12.2024; Vendimin me numër protokolli 01/168 të datës 10.10.2024; Formularët e vlerësimit të eses; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë; Testet me shkrim; Aplikacionin e ankuesit së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkurset përkatëse.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (*në tekstin e mëtejme referuar: IKKL*), më datë 22.08.2024, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00014898, për pozitën “*Drejtor i Departamentit për Hulumtime*” si dhe Konkursin me numër reference RN000148999 për pozitën “*Drejtor i Departamentit të Dokumentimit*”, me afat aplikimi nga data 23.08.2024 deri më datën 21.09.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këto konkurse ka marrë pjesë edhe ankuesi, i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të kandidatëve, dhe si rrjedhojë nga procedura e rekrutimit reference RN00014898, për pozitën “*Drejtor i Departamentit të Dokumentimit*”, rezulton ka arritur gjithsejtë 66.4 pikë, ndërsa nga procedura e rekrutimit reference RN000148999 për pozitën “*Drejtor i Departamentit për Hulumtime*”, ka arritur gjithsejtë respektivisht 65.4, të pamjaftueshme për tu shpallur kandidat fitues.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në IKKL më datë 30.10.2024, ka publikuar Njoftimet sipas të cilave rezulton se procedura e rekrutimit për pozitën *Drejtori i Departamentit të Dokumentimit* si dhe procedura e rekrutimit për pozitën *Drejtor i Departamentit për Hulumtime*, në kuadër të Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (*në tekstin e mëtejme referuar: IKKL*), kanë përfunduar

pa fitues sepse asnjë nga kandidatët nuk ka kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të vlerësimit.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është vlerësuar meritorisht lidhur me përgjigjet e intervistës me gojë, ndaj kërkon mundësinë e ri intervistimit me monitorim nga institucionet kompetente.

Kolegji i Këshillit, gjatë afatit ligjor të vendimmarrjes, me qëllim të evitimit të Këshilli më datë 30.01.2025 ishte drejtuar tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me kërkesën lidhur me ofrimin e opinionit për ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit në këtë procedurë të rekrutimit, lidhur me Vendimin numër protokolli 01/168, të datës 10.10.2024, për themelimin e Komisionit të Pranimit për dy pozitat e sipër theksuara, të Drejtori Ekzekutiv i IKKL-së, i cili ishte vet caktuar “Kryesues” i këtij Komisioni të Pranimit dhe po ashtu ka marrë pjesë në vlerësimin e kandidatëve për pranim.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në rrethanat e krijuara dhe në mbështetje të nenit 85 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.1790/2024 të datës 05.02.2025, kishte vendosur për pezullimin e procedurës lidhur me ankesën e datës 29.11.2024, të parashtruar nga ankuesi, deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështje nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përkatësisht deri në njoftimin zyrtarë që i bëhet Këshillit nga kjo e fundit.

Ndërsa, Këshilli ka pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Përgjigjen me numër reference APK-DPKI-06-192/25 të datës 30.04.2025, të protokolluar me numër 569/25 dhe datë 06.05.2025, lidhur me kërkesën për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit ku përmes kësaj shkrese Agjencia, ka njoftuar se situata e parashtruar nga Këshilli, apriori nuk bie ndesh me dispozitat e LKPI-së.

Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë fillimisht përgjigjen e datës 06.05.2025, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, e duke u bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00014898, për pozitën “Drejtor i Departamentit për Hulumtime” si dhe procedurës së rekrutimit me numër reference RN000148999 për pozitën “Drejtor i Departamentit të Dokumentimit” në IKKL, dhe ka konstatuar së për këto dy pozita kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë të njëjta, si në vijim:

-Arsimimi i kërkuar: Diplomë e Arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor);

-Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë një të një nga kërkesat si në vijim: tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose dy (2) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë e nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose një (1) vit përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë e nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).

Andaj, nga analizimi i shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në paragrafët 5, 6, 7, 8 dhe 9 të nenit 44 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe

ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve/eve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidatëve/eve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidatëve/eve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës; si dhe nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjete (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 8/22 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve; konstaton se ankuesi ka plotësuar kërkesat ligjore të përcaktuara me shpalljen e konkurseve përkatëse; Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi fillimisht ka plotësuar kërkesat ligjore të lartë theksuara për pjesëmarrjen në fazat e vlerësimit të procedurave përkatëse të pranimit, dhe duke qenë se i njëjti ka arritur 51.8 pikë nga testi me shkrim dhe 13.6 pikë nga intervista me gojë, duke arritur kështu gjithsejtë 65.4 pikë të përgjithshme nga procedura e rekrutimit me numër reference RN00014898 për pozitën Drejtor i Departamentit për Hulumtime, si dhe 51.8 nga testi me shkrim dhe 14.6 pikë nga intervista me gojë, duke arritur kështu gjithsejtë 66.4 pikë të përgjithshme nga procedura e rekrutimit me numër reference RN00014898 për pozitën Drejtor i Departamentit për Hulumtime, Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në IKKL, me rastin e nxjerrjes së Njoftimeve të datës 30.10.2024, lidhur me përfundimin e procedurave përkatëse të rekrutimit, ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 dhe 2 të kësaj

rregulloreje, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell të NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat, ngase asnjëri nga kandidatët pjesëmarrës në këto procedura rekrutimi, nga vlerësimi profesional i testit me shkrim dhe intervistës me gojë nuk ka arritur mbi 70% të pikëve totale, ndërsa ankuesi pretendimin për vlerësim jo të drejtë të përgjigjeve nga intervista me gojë, përveç thënieve si në ankesë, nuk mbështetur me asnjë dëshmi konkrete apo provë relevante, ndaj si rrjedhojë pretendimi i ankuesit për ri intervistim është i pa qëndrueshëm, si dhe po ashtu Kolegji thekson se vlerësimi lidhur me përgjigjet e ofruara nga kandidatët sipas legjislacionit në fuqi për me procedurat e pranimit në shërbimin civil është në diskrecion të Komisionit të Pranimit.

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1790/2024

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.J;
- Udhëheqëses së Njësië për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në IKKL; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.